

Udhëzues për Mënyrën e Përdorimit të Mediave për Avokim në Fushën e Aftësisë së Kufizuar

GRUPI PUNUES PËR QASJE NË ZGJEDHJE

Përmbajtja

Përmbledhje.....	2
Njoftim me Grupin Punues për Qasje në Zgjedhje	2
Çështjet që influencojnë nivelin e përkrahjes nga mediat	3
Objektivat e këtij udhëzuesi	3
Aktivitetet strategjike	4
Rreziqet potenciale	9
Syjerime të mëtutjeshme.....	10

Përmbledhje

Me mbështetjen e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) përmes Fondacionit Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) dhe Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) është zhvilluar takimi diskutues me organizatat e personave me aftësi të kufizuar me qëllim të përmirësimit dhe dizajnit të një strategjie për përdorimin e mediave si mundësi dhe instrumente të cilat do të përmirësojnë mbulimin medial dhe prezentimet e çështjeve që preukopojnë personat me aftësi të kufizuar.

Me qëllim të adresimit sa më adekuat të sfidave dhe instrumenteve të nevojshme, në këtë takim është diskutuar për rolin e mediave, strategjitë mediale të përdorura deri më tani, mjetet e nevojshme si dhe ngritjen e kapaciteteve organizative e përmbajtësore të cilat do të ndikojnë në fuqizimin e çështjeve të cilat e ndikojnë pjesëmarrjen dhe prezentimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën publike. Udhëzuesi i draftuar adreson nevojat e dalura nga ky takim dhe i adreson ato përmes këtij dokumenti strategjik ku përfshihen problemet, objektivat, taktikat, mjetet e përgjithshme dhe veprimet e menjëhershme funksionale.

Të gjitha taktikat, mjetet dhe veprimet e përmendura më poshtë shërbejnë në adresimin e mungesave dhe në plotësimin e objektivave të cekura përmes këshillave praktike. Ato janë të strukturuar sipas parimeve të përdorura zakonisht në ndërtimin e strategjive të marrëdhënieve me media.

Për shkak të nevojave të organizatave asaj i janë shtuar edhe mënyrat e shkrimit të Komunikatave dhe të organizimit të Konferencave për Media, të cilat zakonisht mbulohen përmes trajnimeve.

Ky udhëzues i zbatuar në plotësinë e tij garanton efikasitet të plotë.

Njoftim me Grupin Punues për Qasje në Zgjedhje

Grupi Punues për Qasje në Zgjedhje (GPQZ) është një grup punues i përbërë nga shumë hisedarë dhe ka për qëllim të sigurojë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore dhe në jetë publike. Përbëhet nga përfaqësues të organizatave që përfaqësojnë katër lloje të aftësisë së kufizuar (Z. Afrim Maliqi, HandiKOS, Znj. Rukije Gashi, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, Z. Daut Tishuki, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, si dhe Znj. Sebahate Beqiri, Down Syndrome Kosova), dy deputete të Kuvendit të Kosovës (Znj. Ganimete Musliu dhe Znj. Shqipe

Pantina), katër përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë (Z. Florian Dushi, Z. Adnan Rrustemi, Z. Betim Gjoshi, dhe Z. Nexhmedin Hyseni), një përfaqësues nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (Znj. Valbona Millaku), si dhe dy përfaqësues nga institucionet e Kosovës (Znj. Luljeta Kabashi, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Z. Qazim Gashi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale). GPQZ kryesohet nga Z. Afrim Maliqi, dhe ka dy bashkë-kryesues, Znj. Ganimete Musliu dhe Z. Florian Dushi. Shpërndarja e këtij udhëzuesi, që ka për qëllim lehtësimin e aktiviteteve të avokimit të organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar, shënon aktivitetin e parë të këtij grupi punues.

Grupi Punues për Qasje në Zgjedhje mirëpret kontributin e gjithë hisedarëve në aktivitetet që kanë për qëllim promovimin e qasjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuar në procese zgjedhore dhe në jetë publike.

Çështjet që influencojnë nivelin e përkrahjes nga mediat

Gjatë takimit me organizata që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar, çështjet në vijim janë identifikuar si arsye pse nuk ka përkrahje më të madhe nga mediat në aktivitetet avokuese të këtyre organizatave:

- Nivel i ulët i komunikimit me gazetarët dhe mediat.
- Intresim i ulët i gazetarëve dhe mediave për problemet e personave me aftësi të kufizuar.
- Përgjigje e vogël e gazetarëve dhe mediave në ftesat dhe organizimet e OJQ-ve për persona me aftësi të kufizuar.
- Raportim dhe interesim i ulët rreth veprimtarisë së organizatave që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Njohuri të ulëta të gazetarëve dhe mediave në përdorimet e sakta të terminologjisë për personat me aftësi të kufizuar.
- Nivel i ulët i organizimit të mbrendshëm dhe mungesë e kapaciteteve të mjaftueshme për përdorimin e mediave në mënyre efikase.

Objektivat e këtij udhëzuesi

1. Strukturimi i komunikimit me media i organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar
2. Përmirësimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve me gazetarët dhe mediat

3. Rritja e njohurive të gazetarëve, redaktorëve dhe mediave rreth organizatave, terminologjisë dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuar
4. Krijimi i hapësirës mediale dhe të diskutimit për problemet dhe çështjet që preokupojnë organizatat dhe personat me aftësi të kufizuar
5. Rritja e pjesëmarrjes së gazetarëve dhe mediave në aktivitetet me rëndësi të organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar
6. Ngritja e kapaciteteve të organizatave të personave me aftësi të kufizuar, në përmirësimin e njohurive dhe aftësive në shkrim dhe prezantim në media.

Aktivitetet strategjike

Aktivitetet e nevojshme strategjike për arritjen e objektivave janë të paraqitura ndaras për secilën objektive. Secila objektive është e ndërlidhur dhe secili aktivitet strategjik është po ashtu i ndërlidhur me njëri-tjetrin.

Objektivi 1: Strukturimi i komunikimit me media i organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar

Aktivitet strategjike:

Aktiviteti 1: Rrjeti i organizatave të personave me aftësi të kufizuar si dhe individualisht organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar duhet të emërojnë paktën një person që menaxhon dhe mirëmbanë kontaktet me mediat. Kjo është e domosdoshme.

Aktiviteti 2: Personi që menaxhon Marrëdhëniet me Media duhet të ketë pozitë vendimmarrëse dhe të mirëmbajë komunikimin me nivelin më të lartë të organizatave, si shembull drejtorin ekzekutiv apo edhe bordin.

Aktiviteti 3: Komunikimi duhet të jetë i organizuar dhe i centralizuar. Asnjë nga anëtarët nuk mund të flet për media pa u harmonizuar së pari me personin përgjegjës, i cili jep këshilla por edhe shfrytëzon njohuritë dhe resurset e tij/saj për paraqitjen sa më të mirë të organizatave në publik.

Aktiviteti 4: Organizatat duhet të mundësojnë kontaktin sa më të lehtë të gazetarëve dhe mediave me ta— dhe ky komunikim duhet të jetë i menaxhuar dhe i orientuar drejt realizimit të

synimeve të organizatës. Për këtë qëllim duhet të krijohet menjëherë një e-mail adresë enkas për komunikim me media si psh: media@handikos.com.

Aktiviteti 5: Mediat duhet të njoftohen se i tërë komunikimi shkon përmes një adrese të tillë të e-mail dhe përmes personit adekuat. Kjo adresë duhet të publikohet edhe në faqet e internetit si dhe në secilin komunikim me mediat.

Aktiviteti 6: Në faqe të internetit duhet të krijohet një seksion i veçantë për Mediat ku janë të vendosura mënyrat e komunikimit dhe të gjitha komunikatat për shtyp, si dhe aktivitetet e organizatave.

Aktiviteti 7: Krijimi dhe mirëmbajtja e një databaze me emrat dhe kontaktet (telefoni, e-mail adresat) e gazetarëve dhe mediave.

Objektivi 2: Përmirësimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve me gazetarët

Aktivitetet strategjike:

Aktiviteti 1: Takim njoftues me kryeredaktorët/redaktorët e mediave kryesore për t'i prezantuar problemet dhe aktivitetet e organizatave. Të përcjelllet me takime të rregullta me ta.

Aktiviteti 2: Komunikimi i shpeshtë me gazetarët dhe takimet me ta individualisht të paktën në bazë javore.

Aktiviteti 3: Përgjigje e shpejtë ndaj pyetjeve dhe kërkesave të mediave- brenda ditës.

Objektivi 3: Rritja e njohurive të gazetarëve, redaktorëve dhe mediave rreth organizatave, terminologjisë dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuar

Aktivitetet Strategjike:

Aktiviteti 1: Përgatitja e një manuali me shpjegimin e termeve të drejta dhe të gabuara që duhet të përdoret nga gazetarët dhe mediat për definicionet e ndërlidhura me personat me aftësi të kufizuar. Shpërndarja e këtij materiali në forme elektronike dhe të shtypur tek gazetarët dhe mediat. Kjo do të ndihmonte në përmirësim të kualitetit dhe saktësisë së raportimit dhe do të krijonte një afërsi me mediat.

Aktiviteti 2: Publikimi i këtij materiali në format PDF në webfaqet e organizatave të personave me aftësi të kufizuar si dhe në rrjetet sociale të tyre.

Aktiviteti 3: Organizimi i një ose disa tryezave me gazetarë për raportimin mbi personat me aftësi të kufizuar, i bazuar në manualin e përgatitur ku do të shpërndahej Manuali Shpjegues si dhe do të ofroreshin informatat lidhur me objektivat dhe veprimtarinë e organizatës.

Objektivi 4: Krijimi i hapësirës mediale dhe të diskutimit për problemet dhe çështjet që preokupojnë organizatat dhe personat me aftësi të kufizuar

Aktivitetet Strategjike:

Aktiviteti 1: Komunikatat për Media të përdoren sa herë të këtë ndonjë aktivitet të organizatës dhe degëve të saj me të cilin duhet të njoftohet publiku për arritjet e organizatës, kur kërkohet vëmendja dhe sensibilizimin i opinionit për një çështje të caktuar ose kur ka nevojë të reagohet lidhur çështjet të cilat janë diskutuar ose po diskutohen në publik. Mënyra e shkrimit dhe koha e dërgimit që janë të shpjeguara në Objektivën 6, garanton publikimin e tyre nëpër media.

Aktiviteti 2: Përgatitja dhe shpërndarja e së paku një Opinioni/Editoriali në mediat e shkruara dhe Online çdo muaj, në të cilën potencohet dhe shtjellohet një problematikë me rëndësi për personat me aftësi të kufizuar. Sigurimi që përmes bashkëbisedimit paraprakë me redaktorët një i tillë edhe do të publikohet në ato media duke u shpjeguar se bëhet fjalë për një përgjegjësi shoqërore që mediat e kanë si mision të tyre. Publikimi i Opinioni/Editorialit duhet të bëhet edhe në website dhe rrjete sociale të organizatave.

Aktiviteti 3: Letrat për Redaktorët. Në fillim të vitit dhe pastaj në çdo tre muaj të shkruhen dhe të dërgohen letra drejtuar redaktorëve- të cilat nuk janë domosdoshmërisht për publikim- por kanë synimin që ata të informohen, vetëdijesohen dhe influencohen lidhur me çështje të rëndësishme për persona me aftësi të kufizuar. Në këto letra mund të kërkohet edhe ndihma/përkrahja e tyre në avokimin e çështjeve dhe rëndësi.

Aktiviteti 4: Aktivitetet e degëve të organizatave duhet të bëhen lajm kombëtar përmes përdorimit të mediave kombëtare, përmes Komunikatave për Shtyp apo edhe ftesave për mbulim nga televizionet kombëtare. Është e rëndësishme të përfshihen edhe televizionet lokale.

Aktiviteti 5: Shembujt të personave me aftësi të kufizuar që janë të suksesshëm në jetë dhe veprimtari duhet të shtyhen për prezantim në mediat lokale dhe kombëtare përmes hapësirave mediale (mund të lëshohen edhe Komunikata për Media) dhe duke ftuar televizionet që t'i intervistojnë- duke shfrytëzuar kontaktet mediale të krijuara dhe të mirëmbajtura më herët.

Aktiviteti 6: Një herë në vit Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar të ndaj çmime për gazetarët që kanë mbuluar më shumë dhe në mënyrë më korrekte storiet për personat me aftësi të kufizuar.

Objektivi 5: Rritja e pjesëmarrjes së gazetarëve dhe mediave në aktivitetet me rëndësi të organizatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar

Aktivitetet strategjike:

Aktiviteti 1: Konferencat për Media. Të organizohen Konferenca për Media në rastet kur organizatat kanë për të bërë publik një arritje të madhe ose për të kërkuar e vetëdijësuar opinionin për çështje të rëndësisë së madhe. Për të gjitha çështjet tjera duhet të përdorën mjetet tjera të komunikimit të cilat janë renditur më lartë. Konferencat për Mediat në një situatë normale nuk mund të tejkalojnë numrin 3 në vit.

Aktiviteti 2: Të dërgohen ftesa tek media për secilën ngjarje, vizitë ose aktivitet të organizatave të personave me aftësi të kufizuar. Mënyrat se si dërgohen ftesat dhe koha kur dërgohen ato, që shpjegohen më poshtë, rezulton në mbulim më të mirë të storieve.

Objektivi 6: Ngritja e kapaciteteve të organizatave të personave me aftësi të kufizuar, në përmirësimin e njohurive dhe aftësive në shkrim dhe prezentim në media

Aktiviteti 1: Komunikatat për Media: Krijimi dhe përdorimi i suksesshëm i tyre

Komunikatat për Media duhet të dërgohen sa herë të këtë ndonjë aktivitet të organizatës dhe degëve të saj me të cilin duhet të njoftohet publiku për arritjet e organizatës, kur kërkohet vemendja dhe sensibilizimin i opinonit për një çështje të caktuar, ose kur ka nevojë të reagohet lidhur me një ose disa çështje të cilat janë diskutuar ose po diskutohen në publik.

Në mënyrë që Komunikatat për Media të jenë efektive, organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar duhen të marrin në konsideratë këto pika:

- Duhet të tentoni të dërgoni Komunikata për Media të paktën njëherë në muaj, në mënyrë që çështjet me të cilat merreni të kenë një vijueshmëri tek opinioni publik;
- Shkrimi i komunikatave duhet t'i besohet personit të trajnuar për shkrim ose një kompanie që merret me Marrëdhëniet me Publikun, që efekti i saj të jetë ai që kërkohet;
- Komunikatat për Media nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë;

- Gjatë hartimit të tyre duhet të përdoret një gjuhë e kuptueshme për të gjithë ndërsa cilido definicion që detyroheni ta përdorni duhet shpjeguar në detaje për ta bërë më të kuptueshëm për lexuesin;
- Komunikatat për Media duhet dërguar tek media para orës 16:00, me qëllim që mediat të kenë kohë të mjaftueshme për t'i publikuar ato;
- Gjysmë ore pas dërgimit- ose më së largu deri në ora 17:00 duhet të kontaktohen me telefon të gjitha mediat për të konfirmuar nëse e kanë pranuar Komunikatën dhe për tu interesuar nëse ajo do të publikohet.

Komunikata për Media duhet të përmbajë këto elemente:

- Llogon dhe adresën e organizatës;
- Emërtimin Komunikatë për Media (të shkruar me shkronja të mëdha);
- Titullin;
- Vendin dhe datën nën titull të formatizuar me Italic;
- Tekstin përcjellës me format të rregullt dhe me një madhësi të shkronjave prej 11-12;
- Në fund të Komunikatës për Media duhet të lihet numri kontaktues, si dhe adresa e e-mail adresës ku gazetarët mund të drejtohen për pyetje apo sqarime shtesë.

Komunikata për Media duhet të dërgohet përmes e-mail si e bashkangjitur në format Word si dhe e kopjuar në hapsirën për shkrim të e-mailit, për ata që ndoshta kanë probleme që ta hapin në formatin Word.

Aktiviteti 2: Konferencat për Media/Ngjarjet mediale: Organizimi dhe strukturimi i tyre

Konferencat për Media duhet të organizohen vetëm në rastet kur organizatat kanë për të bërë publik një arritje të madhe ose për të kërkuar e vetëdijësuar opinionin për çështje të rëndësishme të madhe. Për të gjitha çështjet tjera duhet të përdorën mjetet tjera të komunikimit të cilat janë renditur më lartë.

Disa pika të cilat organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar duhen të kenë parasysh kur organizojnë Konferenca për Media përfshijnë:

- Konferencat për Mediat në një situatë normale nuk mund të tejkalojnë numrin 3 në vit.
- Ato kërkojnë përgatitje paraprake më intenzive që marrin të paktën disa ditë.
- Hapsirat që zgjidhen duhen të jenë të mjaftueshme për të zënë pa problem të gjithë të ftuarit- e në veçanti mediat të cilat janë edhe subjekti i kësaj udhëzuesi.

- Duhet të ketë vend të mjaftueshëm për vendosjen e kamerave dhe lëvizjen e kameramanëve si dhe për vendosjen e diktafonëve dhe mjeteve të tjera që gazetarët përdorin.
- Ftesat për Konferenca për Media duhet të dërgohen një ditë më herët.
- Në mëngjesin e ditës kur mbahen konferencat duhet të kontaktohen edhe njëherë mediat për tu siguruar që ata e kanë pranuar ftesën dhe për tu interesuar dhe inkurajuar ata që të dërgojnë ekipet e tyre për të përcjellur ngjarjen.
- Ftesat që dërgohen me e-mail duhet të përmbajnë temën e konferencës, datën-orën-dhe vendin, si dhe folësit e pjesëmarrësit e konferencës.
- Një Komunikatë për Media që mbulon temën e konferencës duhet të jetë gati për tu shpërndarë tek gazetarët menjëherë pas përfundimit të saj. E njejta duhet të dërgohet me e-mail tek të gjitha mediat më pas, për tu siguruar se me përmbajtjen e konferencës janë të njoftuar edhe ata që nuk kanë qenë prezent.
- Fjalimi kryesor poashtu duhet të ju shpërndahet gazetarëve të pranishëm, si dhe me e-mail të gjitha mediave, menjëherë pas përfundimit të konferencës.
- Nëse mundësitë e lejojnë duhet të angazhohet edhe një fotograf dhe fotografitë nga ngjarja të ju dërgohen të gjitha mediave bashkangjitur me komunikatën. Një video xhirim nga konferenca- fjalimet kryesore- do të ishte i mirëseardhur për televizionet dhe mediat online.
- Raste si këto do të duhej të shfrytëzohen edhe që të bisedohet me shtruar për çështjet e ngritura me gazetarët e interesuar edhe në mënyrë informale, pas përfundimit të konferencës.
- Organizatat do të duhej të shpërndajnë materiale të shtypura rreth organizatës- broshura, manuale etj- tek gazetarët e pranishëm në konferencë në mënyrë që ata t'i njoftojnë sa më shumë për veprimtarinë e tyre.

Rreziqet potenciale

Rekomandimet e këtij udhëzuesi mund të mos kenë rezultate nëse:

- Udhëzuesi nuk implementohet në tërësi, me të gjitha rekomandimet që përfshinë.
- Roli dhe rëndësia e Marrëdhënieve me Publikun nuk kuptohet mirë nga organizatat, gjë që do të nënkuptonte edhe injorimin e këtij udhëzuesi dhe aktiviteteve që janë hartuar aty.
- Nuk ka trajnim adekuat të personit/personave që janë përgjegjës për zbatimin në praktikë të këtij udhëzuesi.

Sygjerime të mëtutjeshme

Për rezultate më të mira, organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar mund të konsiderojnë edhe:

- Trajnimin e stafit për të përmbushur në mënyrë kualitative veprimet e përcaktuara në këtë udhëzues.
- Përgatitjen e një Plan dhe Program Vjetor të Komunikimit me Publikun bazuar në aktivitete e planifikuara të tyre.